



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës për pranimet në ciklin e parë të studimeve bachelor dhe një program të integruar të ciklit të dytë, për vitin akademik 2023-2024, janë si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

1. Programi i studimit **Biologji**

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (*mesatare e thjeshtë*), përbën **70% të vlerësimit**
- Nota e Biologjisë 12 (*kurrikul me zgjedhje, viti III*) 20%
- Nota e Kimisë 12 (*kurrikul me zgjedhje, viti III*) 10%

Formula e llogaritjes: Pikët totale = $M_{VKM} * 70 + N_{Biologji12} * 20 + N_{Kimi12} * 10$

2. Programi i studimit **Bioteknologji**

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (*mesatare e thjeshtë*), përbën **70% të vlerësimit**
- Nota e Biologjisë 12 (*kurrikul me zgjedhje, viti III*) 20%
- Nota e Kimisë 12 (*kurrikul me zgjedhje, viti III*) 10%

Formula e llogaritjes: Pikët totale = $M_{VKM} * 70 + N_{Biologji12} * 20 + N_{Kimi12} * 10$

3. Programi i studimit **Kimi**

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (*mesatare e thjeshtë*), përbën **70% të vlerësimit**
- Mesatarja e Kimisë nga kurrikula bërthamë e vitit I dhe II 10%
- Mesatarja e Matematikës nga kurrikula bërthamë e vitit I dhe II 10%
- Mesatarja e Fizikës nga kurrikula bërthamë e vitit I dhe II 10%

Formula e llogaritjes: Pikët totale = $M_{VKM} * 70 + M_{KimiB} * 10 + M_{MatematikëB} * 10 + M_{FizikëB} * 10$

3. Programet e studimit **Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore**

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (*mesatare e thjeshtë*), përbën **50% të vlerësimit**
- Nota mesatare e Kimisë (*kurrikul bërthamë viti I+II*) 10%
- Nota mesatare e Biologjisë (*kurrikul bërthamë viti I+II*) 10%
- Nota mesatare e Fizikës (*kurrikul bërthamë viti I+II*) 10%
- Nota e Kimisë 12 (*kurrikul me zgjedhje, viti III*) 10%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

f. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{Kimi 12}} * 10 + M_{\text{Biologi}} * 10 + M_{\text{Fizike}} * 10 + N_{\text{Kimi 12}} * 10 + N_{\text{Fizika 12}} * 10$$

4. Programi i studimit **Matematikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 30%
- c. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%

Formula e llogaritjes Pikët totale = $M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{MatematikaB}} * 30 + N_{\text{MatematikaA}} * 20$

5. Programi i studimit **Fizikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- c. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- d. Nota mesatare e Kimisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%
- f. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{Fizike}} * 10 + M_{\text{MatematikaB}} * 10 + M_{\text{Kimi}} * 10 + N_{\text{Fizika12}} * 10 + N_{\text{MatematikaA}} * 10$$

6. Programi i studimit **Informatikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 25 %
- c. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 5%
- d. Nota mesatare e TIK (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Matematikës në Maturë Shtetërore 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{MatematikaB}} * 25 + M_{\text{Fizike}} * 5 + M_{\text{TIK}} * 10 + N_{\text{Matematika 12}} * 10$$





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

7. Programi i studimit **Inxhinieri Matematike dhe Informatike**
- | | |
|--|--------------------------|
| a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (<i>mesatare e thjeshtë</i>), përbën | 50% të vlerësimit |
| b. Nota mesatare e Matematikës (<i>kurrikul bërthamë viti I+II+III</i>) | 30% |
| c. Nota e provimit të Matematikës në Maturë Shtetërore | 10% |
| d. Nota e Matematikës 12 (<i>kurrikul me zgjedhje viti III</i>) | 10% |

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{MatematikëB}} * 30 + N_{\text{Nota e Matematikës në Maturë}} * 10 + N_{\text{MatematikësA}} * 10$$

8. Programi i studimit **Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**
- | | |
|--|--------------------------|
| a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (<i>mesatare e thjeshtë</i>), përbën | 50% të vlerësimit |
| b. Nota mesatare e Matematikës (<i>kurrikul bërthamë viti I+II+III</i>) | 25% |
| c. Nota mesatare e Fizikës (<i>kurrikul bërthamë viti I+II</i>) | 5% |
| d. Nota mesatare e TIK (<i>kurrikula bërthamë viti I+II</i>) | 10% |
| e. Nota e Matematikës 12 (<i>kurrikul me zgjedhje viti III</i>) | 10% |

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{MatematikëB}} * 25 + M_{\text{Fizikë}} * 5 + M_{\text{TIK}} * 10 + N_{\text{Matematikës12}} * 10$$

9. Programi i studimit **Shkenca Natyrore Mjedisore/Natural and Environmental Sciences (Double Degree)**
- | | |
|--|--------------------------|
| a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përbën | 50% të vlerësimit |
| b. Nota mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore | 10% |
| c. Nota mesatare e Biologjisë (<i>kurrikul bërthamë viti I+II+III</i>) | 10% |
| d. Nota mesatare e Kimisë (<i>kurrikul bërthamë viti I+II+III</i>) | 10% |
| e. Nota mesatare e Fizikës (<i>kurrikula bërthamë viti I+II+III</i>) | 10% |
| f. Nota e Gjeografisë (<i>kurrikul me zgjedhje viti I+II+III</i>) | 10% |

Formula e llogaritjes:

$$\text{Pikët totale} = M_{\text{VKM}} * 50 + M_{\text{MSh}} * 10 + M_{\text{Biologji}} * 10 + M_{\text{Kimi}} * 10 + M_{\text{Fizikë}} * 10 + M_{\text{Gjeografi}} * 10$$

Shënim: Për programet e studimit **Bachelor Informatikë** dhe **Bachelor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**, profilet e shkollave të mëposhtme do të kenë **koeficient 1**:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Emërtimet e Profileve
GJIMNAZ
HARRY FULTZ ELEKTRONIKË
PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI
INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARESH (HERMANN GMEINER)
PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI
ELEKTRONIKË NË TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT
SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-FRENGJISHT
SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-ITALISHT
SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT
GJIMNAZ - f1
GJIMNAZ - f2

Profilat e shkollave të mesme të tjera do të kenë koeficient 0.8.

Për shkollat e mesme profesionale Teknologji Informacioni dhe Komunikimi propozojmë kriteret si më poshtë:

Programi i studimit	Lëndët	Përqindja
Informatikë	TIK	10%
	Matematikë	25%
	Fizikë	5%
	Nota e provimit të Matematikës në provimin e Maturës Shtetërore	10%

Programi i studimit	Lëndët	Përqindja
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	TIK	10%
	Matematikë	25%
	Fizikë	5%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

	Nota e provimit të Matematikës në provimin e Maturës Shtetërore	10%
--	---	-----

Fakulteti i Shkencave Sociale

A. Koeficienti i shkollave

1. Shkollat e kategorisë Gjimnaz dhe Gjimnaz seksioni dy gjuhësh shqip-italisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht; shkollat e kategorisë Pedagogjike, Gjimnazi Gjuhësor, Shërbimet sociale dhe shëndetësore dhe Shkolla Administrim-Biznes kanë koeficientin 1.2
2. Të gjitha shkollat e tjera të kategorisë profesionale kanë koeficientin 1.

B. Kriteret e pranimit

1. 60%- Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme
 $Rezultati\ 1 = Nota\ mesatare\ e\ shkollës\ së\ mesme\ x\ 0.6$
2. 40% - Nota mesatare aritmetike e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje të maturës shtetërore.
 $Rezultati\ 2 = Nota\ mesatare\ e\ provimeve\ të\ Maturës\ Shtetërore\ x\ 0.4$

$$Rezultati\ final = (Rez.1 + Rez.2) \times Koeficientin\ e\ shkollës\ x\ 100$$

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

1. Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e tre viteve të shkollës mesme vlerësohet **80%**
2. Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e provimeve të Maturës Shtetërore vlerësohet **20%**

Formula për llogaritjen e pikëve:

$$M1 = a/b$$

- a- Shumatorja e notave të 3 (tre) viteve të shkollës mesme
- b- Numri i notave të 3 (tre) viteve

$M1 = 80\%$ të vlerës totale të pikëve të kandidatit për student

$$M2 = c/d$$

- c- Shumatorja e notave të maturës shtetërore
- d- Numri i notave të maturës shtetërore





66

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

M2=20% të vlerës totale të pikëve të kandidatit për student

Fakulteti i Drejtësisë

1. Nota mesatare e përgjithshme e të gjithë viteve të shkollës së mesme **40% të vlerësimit**
2. Nota mesatare e të gjithë provimeve të maturës shtetërore **10% të vlerësimit**
3. Lëndët formuese:
 - a. Gjuhë Shqipe (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 10%
 - b. Gjuhë e huaj, e parë (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 10%
 - c. Letërsi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 10%
 - d. Qytetari (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
 - e. Histori (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
 - f. Ekonomi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
 - g. Matematikë (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH) 5%

4. Koeficienti i shkollës së mesme

- Të gjitha shkollat e mesme gjimnaze (përfshirë gjimnazin me kohë të shkurtuar) e kanë koeficientin 1.2
- Të gjitha shkollat e mesme me karakter profesional e kanë koeficientin 1.0

Fakulteti i Ekonomisë

1. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë) përbën **50 % të vlerësimit**
2. Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore) përbën **50 % të vlerësimit:**

- a. Matematikë 15%
- b. Ekonomi 15%
- c. Fizikë 10%
- d. Gjuhë e huaj 10%





67

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të **ciklit të parë** në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kategoritë e mëposhtme:
 - a) studentët që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas VKM-së nr. 403 datë 03.06.2020;
 - b) kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj;
 - c) si dhe shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe

Filiali i UT-së Sarandë

Kritetet e pranimit në ciklin e parë

- Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në degën Administrim Biznesi kriteret janë të njëjta me ato të Fakultetit të Ekonomisë Tiranë.
- Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në degën Gjuhë Angleze kriteret janë të njëjta me ato të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Tiranë.

